

URDHËR
Nr. 406, datë 4.6.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E
BULLGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

URDHËROJ:

Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
 - b) zogjve 24-orësh;
 - c) shpendëve dekorativë;
 - ç) materialit biologjik të shpendëve;
 - d) vezëve të shpendëve;
 - dh) mishit të shpendëve i patrajtuar termikisht;
 - e) nënprodukteve të shpendëve të patrajuara termikisht,
- nga shteti i Bullgarisë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	*Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1	Haskovo	Haskovo*	
2	Haskovo	Simeonovgrad*	
3	Plovdiv	Brezovo*	
4	Plovdiv	Sadovo*	
5	Plovdiv	Kaloyanovo*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

1. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.
 2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajuara termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.
 3. Urdhri nr. 338, datë 10.5.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”, shfuqizohet.
 4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj